REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës:	2018:039465
Datë:	05.04.2019
Numri i dokumentit:	00270306

P.nr. 8/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari Shaqë Curri, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Besa Dervishaj, në çështjen penale ndaj të pandehurit F. L. nga Peja, për shkak të veprës penale të kanosjes nga neni 185 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti për krime të përgjithshme, PP/II.nr.2833/17 të datës 11.01.2018 duke vendosur në lidhje me kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimorë PP/II.nr.2833/17 të datës 11.01.2018, jashtë seance me datë 04.03.2019 merr këtë:

A K T GJ Y K I M

PRANOHET kërkesa Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për krime të përgjithshme, PP/II.nr.2833/17 të datës 11.01.2018,dhe kjo gjykatë, pa mbajtur shqyrtim gjyqësor jep **URDHËR NDËSHKIMOR.**

I pandehuri F. L., i lindur me datë ... në Pejë, ku edhe banon në Lagjen ...., i biri i B. dhe i nënës M. e lindur K., me gjendje të mirë ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion punëtor fizik, posedon telefonin me numër ..., shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me datë 13.11.2017, rreth orës 16:00 në Pejë, me qëllim frikësimi seriozisht e ka kërcënuar të dëmtuarën E. N. se do ti shkaktoj ndonjë të keqe, në atë mënyrë që për shkak të prishjes

2018:039466

së lidhjes martesore që kanë pasur, ditën kritike i pandehuri e thërret në telefon të dëmtuarën, e ku i drejtohet me fjalët kërcënuese "arin që ta linte te motra e tij V. në lokal dhe nëse nuk ka punë me të, vendin askund nuk kam me ta lënë", me çrast e dëmtuara duke e ndjerë vetën të rrezikuar e paraqet rastin në polici,.

-me çka ka kryer vepër penale të kanosjes nga neni 185 par.1 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata konform nenit 7,42, nenit 43 par.1 nënpar 3.1 të KP rK-së dhe nenit 185 par.1 të KPK-së, nenit 495 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Ashtu që të pandehurit **F. (B.) L. i cakton dënim me gjobë në shumë prej 200€ (dyqind euro)** e të cilin dënim është e obliguar që ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i pandehuri i lartcekur dënimin nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimi me gjobë gjykata do ta zëvendësoi me dënim burgu, në kohëzgjatje prej 10 ditësh, duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 20€ në afat prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

I pandehuri obligohet që të paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 30 euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 463 par.1 dhe 2 të KPP të Kosovës, palët e dëmtuar E. N. për kërkesën e saj pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për krime të përgjithshme, ndaj të pandehurit F. L. nga Peja, ka ngrit aktakuzë PP/II.nr.2833/17 të datës 11.01.2018 për vepër penale të kanosjes nga neni 185 par.1 të KPRK-së.

Konform nenit 493 të KPP të Kosovës, PPK në Pejë pas ngritjes së aktakuzës ka kërkuar që gjykata pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësorë, të lëshoi urdhër ndëshkimorë me të cilin të pandehurit ti shqiptoi dënim me gjobë.

Para se te vazhdohet me arsyetim të aktgjykimit për palën e pa udhëzuar është e nevojshme që ti referohemi dispozitës së nenit 185 paragrafi 1 të KPK-së, e cila dispozitë për kryesin e kësaj vepre penale parasheh dënim me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.

2018:039466

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes konform nenit 495 të KP të Kosovës, gjeti se janë plotësuar kushtet nga dispozita e nenit 493 të KPP të Kosovës dhe pa mbajtur shqyrtimin gjyqësorë vendosi që ta pranoi kërkesën e Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për krime të përgjithshme për dhënien e urdhrit ndëshkimorë dhe shqiptoi ndaj të pandehurit dënimin me gjobë si në dispozitiv të aktgjykimit.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura shkresave të lëndës: raporti i oficerit hetues Rr.M. SH. e datës 23.11.2017, deklarata e të dëmtuarës të dhëna në polici me datë 23.11.2017 dhe në prokurori me datë 09.01.2018, deklarata e të pandehurit e dhënë në polici me datë 25.11.2017, deklarata e dëshmitarëve R. S., G. N. dhe V. H. të dhëna në polici me datë 28 dhe 30.11.2017, si dhe shkresat e tjera të cilat janë pjesë përbërëse e shkresave të lëndës, janë prova të besueshme mbi bazën e të cilave vërtetohet se i pandehuri është kryes i veprës penale për të cilën është akuzuar.

Me rastin e matjes së shqiptimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat konform nenit 73 të KP të Kosovës, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ashtu që si rrethanë lehtësuese gjeti se më parë, nga shkresat e lëndës nuk shihet se i pandehuri i lartë cekur ka qenë i dënuar dhe ndaj tij nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale, Rrethanë renduese për të pandehurin nuk ka pasur.

Andaj, gjykata të pandehurin e dënoi si në dispozitiv të aktgjykimit duke qenë i bindur se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale, se me këtë dënim ndaj tij mund të arrihet qëllimi i dënimit të cilën e parasheh dispozita e nenit 41 të KP të Kosovës.

Vendimi lidhur me paushallin gjyqësorë u murr konform nenit 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 të KPP të Kosovës.

Konform nenit 39 par.1, 2, 3, nënpar.3.1, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e obligoi në pagesën e taksë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike u mur konform nenit 463 par.1 dhe 2 të KPP të Kosovës.

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i përgjithshëm,
P.nr. 08/18, të datës 04.03.2019.

Bashkëpunëtore profesionale **GJ Y Q T A R I**
Besa Dervishaj **Shaqë Curri**

UDHËZIM JURIDIK:

2018:039466

Kundër këtij aktgjykimi mund
të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh
gjyqtares në këtë çështje e përmes zyrës së
pranimit të kësaj gjykate.